Gjatë aktivitetit, AIDSSH ekspozoi gjithashtu botimet e tij, materialet informuese mbi veprimtarinë institucionale, ekspozitën me portretet e ish-të burgosurve politikë dhe vendosi kode QR në ambientet e ish-Burgut të Spaçit, të cilat u mundësojnë vizitorëve akses të drejtpërdrejtë në platformën www.spac.al.



Pas vizitës në ambientet e ish-Burgut të Spaçit, pjesëmarrësit u zhvendosën në Shpal të Mirditës, ku anëtari i Autoritetit, Altin Hoxha, prezantoi rezultatet e punës shumëvjeçare të AIDSSH-së për qartësimin e fatit të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist.

Ai shpjegoi se, mbi bazën e dokumenteve arkivore, dëshmive të ish-të burgosurve politikë dhe familjarëve të tyre, si edhe verifikimeve në terren, Autoriteti ka zhvilluar hetime administrative që kanë çuar në dokumentimin e 29 personave të zhdukur gjatë vuajtjes së dënimit në kamp-burgun e Spaçit.

Hoxha prezantoi edhe punën për identifikimin e tre vendvarrimeve të dyshuara, të publikuara tashmë edhe në platformën www.spac.al.

Dy prej tyre ndodhen në zonën e Shpalit, Mirditë, ku Autoriteti ka vendosur tabela shenjëzuese në bashkëpunim me pushtetin vendor. Njëri vendvarrim dyshohet se përmban mbetjet mortore të ish-të burgosurve politikë që humbën jetën gjatë vuajtjes së dënimit në Spaç dhe trupat e të cilëve nuk iu dorëzuan familjarëve, ndërsa vendvarrimi i dytë lidhet me katër të pushkatuarit pas Revoltës së Spaçit.

Ai bëri të ditur se këto rezultate janë arritur pas një procesi të gjatë kërkimor dhe në bashkëpunim me Komisionin Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP), i cili ka kryer verifikime në terren me metoda shkencore joinvazive, përmes specialistëve të arkeologjisë dhe antropologjisë forenzike. Sipas rezultateve paraprake, janë përforcuar indiciet për praninë e mbetjeve mortore në këto zona, duke krijuar bazën për vijimin e procedurave të identifikimit dhe rikthimin e dinjitetit të viktimave.

Në përfundim të aktivitetit, pjesëmarrësit vizituan nga afër dy vendvarrimet e dyshuara në Shpal, ku u njohën me procesin e ndjekur nga Autoriteti për evidentimin dhe dokumentimin e tyre.

Gjatë diskutimeve, Kryetarja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik, Jorida Tabaku, theksoi domosdoshmërinë që Spaçi të shndërrohet në një qendër kombëtare kujtese dhe të rikthehet dinjiteti i familjeve që prej dekadash kërkojnë fatin e të afërmve të tyre.

Ndërsa Ambasadori i Bashkimit Evropian në Shqipëri, Silvio Gonzato, bëri thirrje për vijimin e hetimeve, gërmimeve shkencore dhe bashkëpunimit institucional për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur, duke theksuar se ballafaqimi me të kaluarën është një kusht i domosdoshëm për drejtësinë, kujtesën dhe ndërtimin e një shoqërie demokratike

AIDSSH PËRKUJTON AVOKATËT E PËRNDJEKUR DHE SHTYPJEN E MBROJTJES LIGJORE GJATË DIKTATURËS

Tiranë më 20 korrik, 2026

Në Ditën Ndërkombëtare të Drejtësisë Penale, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) organizoi veprimtarinë përkujtimore "Mbrojtja nën pranga: Përkujtimi i avokatëve mbrojtës dhe shtypja e drejtësisë (1944–1966)", kushtuar historisë së avokatëve të përndjekur dhe goditjes së mbrojtjes ligjore gjatë regjimit komunist.

Kryetarja e AIDSSH-së, Dr. Gentiana Sula, theksoi se aktiviteti nuk synon vetëm të kujtojë disa fate individuale, por të rindërtojë historinë e një profesioni dhe të kuptojë se çfarë ndodhi me të drejtën e mbrojtjes në Shqipëri. "Sot, duke kujtuar avokatët e përndjekur, nuk ndërtojmë vetëm një listë viktimash. Ne përpiqemi të rindërtojmë historinë e një profesioni. Të kuptojmë çfarë ndodhi me të drejtën e mbrojtjes. Të dallojmë mekanizmin që e ktheu politikën në akuzë dhe akuzën në dënim",- u shpreh Sula.

Duke iu referuar dokumenteve arkivore dhe punës kërkimore të Autoritetit, ajo bëri të ditur se deri më tani janë identifikuar rreth 130 avokatë që ushtruan profesionin në periudhën e parë të regjimit komunist, ndërsa të paktën 30 prej tyre u dënuan, u burgosën, u internuan, u survejuan, u përjashtuan nga profesioni ose u penguan ta ushtronin atë. "Këto shifra kërkojnë ende plotësim dhe dokumentim të mëtejshëm. Por tabloja është e qartë: nuk u goditën vetëm individë. U godit mundësia që profesioni të qëndronte i pavarur ndërmjet qytetarit dhe shtetit", - theksoi Kryetarja e AIDSSH-së.





Në fjalën e saj, Dr. Sula nënvizoi se avokati është institucioni që vendos ligjin ndërmjet qytetarit dhe pushtetit, ndërsa në një regjim që kërkonte nënshtrimin si normë, edhe ruajtja e etikës profesionale mund të shndërrohej në një akt qëndrese. Ajo kujtoi se suprimimi i avokatisë në vitin 1967 nuk ishte rezultat i një debati profesional apo i nevojës për reformë, por erdhi me vendim partie, duke eliminuar pavarësinë e profesionit dhe duke e zëvendësuar atë me një sistem të kontrolluar nga shteti.

Kryetari i Komisionit për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike, Ulsi Manja vlerësoi aktivitetin si një akt të domosdoshëm të kujtesës historike dhe theksoi se avokatët e përndjekur u ndëshkuan jo sepse shkelën ligjin, por sepse besuan se çdo njeri meriton një mbrojtje të drejtë. "Kur një shtet fillon të ketë frikë nga avokati, ai nuk sulmon thjesht një profesionist. Ai po sulmon vetë shtyllën e drejtësisë. Avokati është mburoja e të drejtave të njeriut dhe e procesit të rregullt ligjor", - u shpreh Manja.

Avokati i Popullit, Endri Shabani, vlerësoi punën e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit si një akt drejtësie të vonuar, duke theksuar se hapja e dosjeve zëvendëson "një version zyrtar të gënjeshtrës me një të vërtetë të dokumentuar". Ai nënvizoi se regjimi komunist i ndëshkoi avokatët pikërisht sepse mbronin qytetarët dhe se monumenti më i mirë për Muzafer Pipën, Erifili Bezhanin dhe Koço Dilon është një sallë gjyqi ku asnjë avokat nuk ka frikë të mbrojë askënd.

Zëvendësministrja e Drejtësisë, Elona Hoxha vlerësoi se ekspozita dhe dokumentet arkivore dëshmojnë se si arbitrariteti u maskua me ligjshmëri gjatë diktaturës komuniste. Ajo theksoi se nderimi për avokatët e përndjekur shprehet sot përmes forcimit të shtetit të së drejtës, garantimit të pavarësisë së profesionit të avokatit dhe ndërtimit të një sistemi drejtësie që respekton dinjitetin e njeriut dhe të drejtën për mbrojtje.





Referati kryesor u mbajt nga anëtari i Autoritetit, Skënder Vrioni i cili paraqiti një analizë krahasuese mbi zhvillimin e avokatisë gjatë viteve 1945–1990, duke theksuar se regjimi komunist e vendosi profesionin nën kontroll të plotë politik, duke kufizuar gradualisht pavarësinë e avokatit deri në suprimimin e avokatisë në vitin 1967. Sipas tij, nuk u vu në diskutim nevoja për mbrojtje juridike, por u ndryshua modeli i saj, duke e shndërruar nga një profesion i organizuar më vete në një shërbim shtetëror të varur nga gjykatat. Skënder Vrioni evidentoi se dokumentet arkivore tregojnë një proces të vazhdueshëm dobësimi të rolit të avokatit. Fillimisht avokatia u vu në shërbim të organeve të pushtetit, më pas u organizua nën kontroll të plotë shtetëror dhe, në vitin 1967, u suprimua me vendim të Byrosë Politike, duke u zëvendësuar nga zyrat e ndihmës juridike pranë gjykatave.

Ndërsa në panelin tematik, Selami Zalli, Drejtori i Përgjithshëm i Kërkesave theksoi se: "Eliminimi i avokatisë nuk kishte si qëllim përmirësimin e sistemit të drejtësisë, por eliminimin e pavarësisë së mbrojtjes ligjore."

Dr. Etleva Demollari, përmes dokumentacion arkivor solli në kumtesën e saj fatin që regjimi komunist u rezervoi shumë prej avokatëve që në vitin 1945 morën përsipër mbrojtjen e të pandehurve në Gjyqin Special. Aristidh Totozani, Spiro Stringa, Haki Karapici, Ilia Çipit, Muzafer Pipa, Vasil Xhaja, Kristo Çevi, Suad Asllani, Kristaq Niço dhe Vasil Bidoshi, të formuar në universi-

tetet më prestigjioze të Evropës, mbrojtën me argumente juridike parimet e së drejtës, përgjegjësinë individuale dhe procesin e rregullt ligjor.

Studimi analizon jo vetëm përballjen e tyre me "drejtësinë popullore", por edhe fatet e tyre të mëvonshme: arrestime, burgime, tortura, survejim, përjashtim nga profesioni dhe, në fund, shuarjen e vetë institucionit të avokatisë në vitin 1966.

Në studimin e saj mbi dokumentet e Arkivit të Autoritetit, Adela Toporja, përgjegjëse e arkivit prezantoi dosjet hetimore-gjyqësore të avokatëve Abdulla Rami, Aristidh Totozani dhe Zija Luniku, të cilat pasqyrojnë jo vetëm funksionimin e drejtësisë politike, por edhe fatet tragjike të juristëve shqiptarë në vitet e para të regjimit komunist. Përmes dokumenteve autentike u evidentuan dënimi me 30 vjet burg i Abdulla Ramit, procedimi penal ndaj Aristidh Totozanit, i cili u shpall i pafajshëm për mungesë provash, si dhe dënimi me vdekje dhe ekzekutimi i Zija Lunikut. Sipas saj, këto dosje nuk janë vetëm akte procedurale, por dëshmi historike që ruajnë kujtesën e njerëzve dhe tregojnë se si sistemi i drejtësisë u përdor për të goditur profesionin e avokatit dhe elitën juridike shqiptare.





Jonel Hibo, (AIDSSH) prezantoi dokumente arkivore mbi fatet e avokatëve Qenan Dibra, Terenc Toçi dhe Baltazar Benusi, duke dëshmuar se regjimi komunist goditi një brez juristësh të formuar në universitetet evropiane, të cilët u dënuan me burg, pushkatim ose u privuan nga e drejta për të ushtruar profesionin. Sipas tij, këto dosje hedhin dritë mbi shkatërrimin e elitës juridike shqiptare në vitet e para të diktaturës

Në përfundim të veprimtarisë, familjarët e avokatëve të përndjekur, Haki Karapicit, Koço Dilos, Ali Erebarës dhe Tefik Mbrojes, theksuan nevojën që historia dhe sakrifica e tyre të mos mbeten në harresë, por të përkujtohen dhe të nderohen si pjesë e kujtesës kombëtare. Ata ndanë dëshmi mbi fatin e avokatëve dhe vuajtjet që regjimi komunist u shkaktoi familjeve të tyre, duke dëshmuar se pas çdo dosjeje arkivore fshihet historia e një njeriu dhe e një familjeje.

Përmes dëshmisë së gazetares Nini Haxhistasa, e afërme e Erifili Bezhani erdhi jeta tragjike e njërës prej juristeve dhe avokateve të para shqiptare. E diplomuar në Francë, ajo u burgos për bindjet e saj demokratike, iu mohua e drejta për të ushtruar profesionin dhe vdiq në vitin 1959, pas viteve të përndjekjes dhe punës së detyruar si fshesare në Tiranë.

Mesazhi që përshkoi të gjithë aktivitetin ishte se dokumentet arkivore tregojnë çfarë ndodhi, ndërsa dëshmitë e familjarëve i japin zë pasojave njerëzore të represionit. Së bashku, ato ndihmojnë në kuptimin e mekanizmave të shtypjes, ruajnë kujtesën historike dhe shërbejnë si një thirrje që padrejtësi të tilla të mos përsëriten më.

NË KËRKIM TË ESHTRAVE TË DOM NIKOLL GAZULLIT

Grupi i punës i Autoritetit zhvillon verifikime në Shënkoll të Shkrelit

Shkrel, Shkodër 21 Korrik, 2026

Në kuadër të përgatitjeve për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Viktimave të Zhdukjeve me Forcë, më 28 gusht, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) po zhvillon një seri verifikimesh administrative dhe inspektimesh në terren për evidentimin dhe shenjëzimin e vendvarrimeve të dyshuara të viktimave të regjimit komunist.

Grupi i punës, i drejtuar nga anëtari i Autoritetit, Gjergj Marku, zhvilloi një vizitë pune në zonën e Shkrelit, Malësi e Madhe, si pjesë e procesit të kërkimit dhe dokumentimit të rasteve të personave të zhdukur gjatë diktaturës komuniste.

Qëllimi i vizitës ishte mbledhja e informacionit dhe verifikimi në terren i të dhënave që lidhen me vendndodhjen e mundshme të eshtrave të Dom Nikoll Gazullit, një prej figurave më të rëndësishme të klerit katolik shqiptar, i ekzekutuar pa gjyq nga regjimi komunist në vitin 1946 dhe që vijon të konsiderohet i zhdukur.

Gjatë vizitës, grupi i punës u prit nga Dom Nikoll Toma, meshtar i Kishës së Shënkollit në Shkrel, i cili prej vitesh ka zhvilluar një punë të vazhdueshme për mbledhjen e dëshmive, kujtesës gojore dhe të dhënave historike mbi vendin ku mendohet se janë varrosur eshtrat e Dom Nikoll Gazullit.





Informacioni i mbledhur ndër vite nga Dom Nikoll Toma përbën një udhërrëfyes të rëndësishëm për procesin e verifikimeve që po zhvillon Autoriteti. Dëshmitë e mbledhura prej tij, njohja e territorit dhe puna këmbëngulëse për ruajtjen e kujtesës historike janë një kontribut me vlerë për identifikimin e vendndodhjeve të dyshuara dhe për zbardhjen e fatit të një prej figurave më të shquara të kulturës dhe klerit shqiptar.

Grupi i punës inspektoi Kishën e Shënkollit, një nga të paktat kisha që i mbijetoi shkatërrimeve të regjimit komunist, si edhe zonën Stërkuj–Dedaj, ku u kryen verifikime në terren mbi vendndodhjen e dyshuar të eshtrave të Dom Nikoll Gazullit. Të gjitha të dhënat e mbledhura do t'i nënshtrohen verifikimeve të mëtejshme administrative në funksion të procesit të identifikimit dhe shenjëzimit të vendvarrimeve të dyshuara.

Vizita në Shkrel është pjesë e punës që AIDSSH zhvillon në disa qarqe të vendit për evidentimin e vendvarrimeve të viktimave të komunizmit, si dhe për përgatitjen e aktiviteteve përkujtimore të 28 gushtit, ditë që i kushtohet kujtimit të personave të zhdukur me forcë, një dite qe kujtohet prej krijimit të këtij institucioni.

Në përfundim të vizitës, grupi i punës zhvilloi një takim me kryetarin e Shoqatës së ish-të Përndjekurve Politikë të Shkodrës, Zenel Drangu, me të cilin u diskutua mbledhja e dëshmive, fotografive dhe materialeve dokumentare që do të pasurojnë Ekspozitën e Përhershme Informuese, e cila do të inaugurohet në Shkodër më 28 gusht 2026.

Ekspozita synon të sjellë për publikun historinë e persekutimit të klerit katolik dhe të viktimave të regjimit komunist në qarkun e Shkodrës, duke i kthyer dëshmitë individuale në kujtesë kolektive. Një rëndësi të veçantë do t'i kushtohet figurave të meshtarëve dhe priftërinjve që u pushkatuan, u burgosën ose u zhdukën nga regjimi komunist, mes tyre edhe Dom Nikoll Gazullit.

Përtej funksionit përkujtimor, ekspozita është konceptuar edhe si një hapësirë edukimi për brezat e rinj. Përmes vizitave të organizuara me nxënësit dhe të rinjtë e zonës, ajo synon t'i njohë ata jo vetëm me jetën dhe veprën e Dom Nikoll Gazullit, por edhe me historinë e persekutimit të klerit katolik, rezistencën ndaj diktaturës dhe rëndësinë e ruajtjes së kujtesës historike si garanci që këto ngjarje të mos përsëriten më.

Dom Nikoll Gazulli (1895–1946) ishte meshtar katolik, studiues, gjuhëtar dhe folklorist shqiptar, i njohur për kontributin e tij në studimin e gjuhës shqipe dhe mbledhjen e trashëgimisë folklorike. Ai shërbeu si famullitar në Malësinë e Madhe dhe u dallua për veprimtarinë e tij kulturore e atdhetare. Pas vendosjes së regjimit komunist, u shpall kundërshtar i pushtetit dhe më 23 mars 1946 u ekzekutua pa gjyq në zonën e Shkrelit. Eshtrat e tij vijojnë të jenë të pagjetura, ndërsa figura e tij mbetet një nga simbolet e persekutimit të klerit katolik gjatë regjimit komunist në Shqipëri.

KARDINALI ERNEST SIMONI RIKTHEHET NË SPAÇ

Spaç, 31 korrik 2026

Rikthimi i Kardinalit Ernest Simoni në ish-Burgun e Spaçit, ku ai vuajti vite burgimi dhe punë të detyruar gjatë diktaturës komuniste, u shndërrua në një homazh për martirët e regjimit, por edhe në një thirrje të fuqishme për të mos lënë në harresë personat e zhdukur, fati i të cilëve mbetet ende i pazbardhur.

Në ceremoninë përkujtimore, të organizuar me iniciativën e Shoqatës Antikomuniste të të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë, morën pjesë ish-të dënuar politikë, familjarë të viktimave, përfaqësues të institucioneve shtetërore, komuniteteve fetare dhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH).

Në vendin ku dikur kremtonte fshehurazi Meshën dhe punonte në galeritë e minierës, Kardinali Ernest Simoni u lut për të gjithë ata që humbën jetën në Spaç, për të ekzekutuarit, për viktimat e punës së detyruar dhe për personat e zhdukur. Në fund të Meshës u lexua edhe mesazhi i Papa Leonit XIV, i cili e cilësoi Spaçin "një nga faqet më të dhimbshme të historisë së Shqipërisë", ku shumë njerëz "mbartën kryqin e rëndë të padrejtësisë", duke theksuar se asnjë burg nuk mund ta ndajë njeriun nga dashuria e Zotit. (Vatican News)






Në këtë aktivitet, AIDSSH prezantoi punën e tij shumëvjeçare për dokumentimin e historisë së Spaçit dhe të krimeve të diktaturës komuniste. Përmes ekspozitës dokumentare të ngritur në ambientet e ish-burgut dhe posterit me portretet e 28 personave të zhdukur, Autoriteti solli në vëmendje një prej plagëve më të hapura të së shkuarës sonë: mungesën e informacionit për fatin dhe vendvarrimet e shumë viktimave të regjimit.

Prej vitesh, AIDSSH administron dokumente arkivore, mbledh dëshmi dhe zhvillon hetime administrative për personat e zhdukur gjatë regjimit komunist. Në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe familjarët e viktimave, puna e AIDSSH-s ka ndihmuar në identifikimin dhe shënjimin e disa vendvarrimeve të dyshuara, përfshirë edhe zona të lidhura me ish-Burgun e Spaçit.

Gjatë ceremonisë, Kardinali Ernest Simoni bekoi artefakte origjinale të përdorura nga të burgosurit politikë dhe posterin kushtuar personave të zhdukur, duke vizituar gjithashtu ekspozitën e AIDSSH, e cila dokumenton historinë e Spaçit përmes dokumenteve arkivore, fotografive dhe dëshmive të kohës.

Në përfundim të aktivitetit, Kardinali Ernest Simoni u nderua me Dekoratën e Mirënjohjes, të dorëzuar nga bashkëvuajtësi i tij, Zenel Drangu, në një moment me simbolikë të veçantë për kujtesën dhe qëndresën.

Thirrje për bashkëpunim

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit u bën thirrje ish-të përndjekurve politikë, familjarëve të viktimave dhe çdo qytetari që disponon fotografi, dokumente, dëshmi apo informacione mbi personat që kanë vuajtur dënimin në ish-Burgun e Spaçit, veçanërisht për të zhdukurit, t'i vërë ato në dispozicion të Autoritetit.

Çdo dëshmi, sado e vogël të duket, mund të ndihmojë në plotësimin e historisë së Spaçit, në pasurimin e dokumentacionit arkivor, në identifikimin e vendvarrimeve të dyshuara dhe në qartësimin e fatit të personave të zhdukur gjatë diktaturës komuniste.

Kontributi i familjarëve dhe i dëshmitarëve është i pazëvendësueshëm në përpjekjen për të zbardhur të vërtetën historike dhe për t'u kthyer dinjitetin viktimave dhe familjeve të tyre.

Mesazhi i Papa Leoni

Vëlla i nderuar!

Me një mallëngjim të thellë bashkohem shpirtërisht me Eminencën Tuaj dhe me të gjithë ata që janë mbledhur në ish-kampin e burgimit të Spaçit, ku Ju ktheheni pas kaq vitesh për të kremtuar Eukaristinë, Sakrificën e Krishtit, e cila e shndërroi Kryqin nga shenjë vdekjeje në premtim jete.

Ai vend, i gdhendur në kujtesën e popullit shqiptar, mbetet një prej faqeve më të dhimbshme të historisë së tij.

Spaçi ka qenë një vend ku shumë njerëz kanë mbartur kryqin e rëndë të padrejtësisë; gjaku i atyre që kanë vuajtur dhe

kanë vdekur mes atyre maleve e ka ujitur atë tokë, duke e bërë një dëshmi të heshtur besnikërie, guximi e shprese.

Sa shumë lutje do të jenë ngritur drejt Qiellit nga ai vend! Sa përgjërime janë pëshpëritur në zemër! Sa shumë njerëz, të shënuar nga mundimi dhe privimet, ia kanë besuar Zotit shpresën e tyre të fundit!

Memoria na e kujton se asnjë zinxhir nuk është aq i fortë sa të burgosë një ndërgjegje të ndriçuar nga Ungjilli, asnjë natë nuk është aq e gjatë sa të pengojë agimin që Zoti përgatit për bijtë e Vet dhe asnjë burg nuk është aq i thellë sa ta ndajë njeriun nga dashuria e Hyjit (krh. Rom 8,35-39).

Bashkohem në lutje për ata që kanë vuajtur dhe kanë vdekur në Spaç, që kujtimi i tyre të mbetet i gjallë dhe të jetë për brezat e rinj një thirrje e vazhdueshme për të respektuar dinjitetin e pacenueshëm të personit njerëzor, vlerën e lirisë dhe angazhimin për paqen.

Të gjithë të pranishmit ia besoj ndërmjetësimit të së Lumes Mari Virgjër, Nënës së Shpresës, dhe, duke ju siguruar se do t'ju kujtoj në lutje, i jap me gjithë zemër Eminencës Suaj dhe të gjithë pjesëmarrësve në kremtim Bekimin Apostolik të kërkuar.

Nga Vatikani, më 30 korrik 2026

LEONI PP. XIV

BARAKAT MBAJNË GJURMËT, NJERËZIT KUJTESËN – DREJT TURIT TË 24 GUSHTIT

Lushnjë më 12 gusht, 2026

Në vigjilje të turit thenjues tërkujtimor "Peizazhe të internimit", që do të zhvillohet më 24 gusht, Autoriteti ishte në Lushnjë për të përgatitur nga afër itinerarin dhe, mbi të gjitha, për të dëgjuar njerëzit që mbajnë kujtesën e internimit.

Ndalesa e parë – Bashkia Lushnjë

Kryetarja e Bashkisë Lushnjë, Eriselda Sefa, priti përfaqësuesit e Autoritetit dhe shprehu gatishmërinë e plotë të Bashkisë për të mbështetur organizimin e turit përmes strukturave dhe institucioneve vendore, si dhe për t'iu bashkuar këtij udhëtimi përkujtimor më 24 gusht.

Për Bashkinë, ruajtja dhe përcjellja e kujtesës së internimeve është edhe pjesë e historisë së vetë Lushnjës dhe komunitetit të saj. Kryetarja Sefa vlerësoi rëndësinë e evidentimit të këtyre vendeve dhe të historive njerëzore që lidhen me to, veçanërisht për t'ua bërë të njohura brezave të rinj.

Me drejtuesin e muzeut te qytetit, Niko Ferro u diskutua mbi historinë dhe gjurmët që ruajnë këto vende. Takimi u pasurua me një grup përfaqësuesish të Shoqatës së të Përndjekurve Politikë të qytetit, si Gëzim Baruti, përkthyes i frëngjishtes, Elhami Agolli, profesor i matematikës, dhe Shpëtim Brahamaj, i lindur në internim dhe sot drejtues i shoqatës. Bisedat me ta sollën dëshmi, të dhëna dhe kujtime që do të ndihmojnë për t'i dhënë turit jo vetëm saktësi historike, por edhe zërin e njerëzve që e kanë përjetuar atë kohë.





Ndalesa e dytë – Savër

Udhërrëfyesi ishte Sofo Kuqeshi, i rritur në internim, tregoi nëpër vendet ku dikur jetonin familjet e internuara. Bashkë me Vilma Mirakën, e lindur në internim në Savër, u panë nga afër në shtëpitë-kasolle ku dikur ishin detyruar të jetonin familje të të përndjekurve politikë. Vizituam edhe zonjën e familjes Kaba, në një prej banesave që ende mbart gjurmët besnike të asaj kohe.

U inspektuan hapësirat, u dëgjuan kujtimet dhe u mblodhën të dhëna për jetën e përditshme të familjeve të internuara. Në Savër, familje të tëra u detyruan të jetonin për vite e dekada në hapësira minimale, të punonin aty ku u caktohej dhe të rrisnin fëmijët nën peshën e një "biografie" që nuk e kishin zgjedhur. Por Savra nuk mund të tregohet vetëm me barakat. Ajo tregohet nga njerëzit, Zamira Tole Hysa, e cila kishte përjetuar jetën e internimit dhe sot është rikthyer të

jetojë sërish aty ku ka ngritur tashme shtepine e saj te re.

Historitë e Sofo Kuqeshit, Vilma Mirakës, Zamira Tole Hysa, familjes Kaba dhe të njerëzve që takuam në Lushnjë na kujtojnë se pas fjalës "internim" qëndrojnë jetë konkrete: fëmijëri nën kufizime, arsim i penguar nga "biografia", punë e detyruar dhe mundësi të mohuara.

Por edhe diçka që internimi nuk mundi ta administronte: dijen, dinjitetin dhe dëshirën për të qenë i lirë. Memoriali në qendër të Savrës sot mban emrat e atyre që u internuan pafaj.





MBAHET TURI SHENJUES PËRKUJTIMOR "PEIZAZHE TË INTERNIMIT"

Lushnjë, 24 gusht, 2026

Me homazhe në Memorialin e Përndjekjes Politike në Lushnjë dhe me ceremoninë përkujtimore në Savër, nisi turi shenjues përkujtimor "Peizazhe të internimit", i organizuar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në kuadër të aktiviteteve për 23 Gushtin, Ditën Evropiane të Përkujtimit të Viktimave të Regjimeve Totalitare.

Përmes një itinerari në fshatrat dhe vendet e internimit të Lushnjës, turi lidh dokumentet arkivore me dëshmitë e të mbijetuarve dhe me hapësirat ku qindra familje u detyruan të jetonin nën mbikëqyrje, apel, punë të detyruar dhe privim të lirisë.

Aktivitetin e nderoi me praninë e tij Presidenti i Republikës. Në ceremoni morën pjesë kryetarja e Bashkisë Lushnjë, Eriselda Sefa, ish-të internuar, familjarë, përfaqësues institucionalë, studiues dhe qytetarë.

Duke prezantuar qëllimin e turit, kryetarja e AIDSSH-së, Gentiana Sula, deklaroi se përgjegjësia ndaj ish-të përndjekurve politikë nuk mbaron me dënimin e krimeve të diktaturës. Sipas saj, tranzicioni shqiptar nuk ua ktheu viktimave vitet e humbura dhe shpesh u soll ndaj tyre me hipokrizi, zvarritje dhe neglizhencë.

"Shumë viktima u përballën me pengesa të turpshme, zvarritje të pafundme, hipokrizi politike, neglizhencë dhe një administratë shpesh të mefshtë përballë vuajtjes së tyre. Mohimi nuk erdhi më gjithmonë me gjuhën e vjetër të propagandës. Ai vazhdoi përmes heshtjes, harresës, premtimeve të pambajtura dhe trajtimit sipërfaqësor të problemeve të viktimave", deklaroi Sula.





Ajo solli në vëmendje njerëzit që u larguan nga jeta pa marrë përgjigje për fatin e familjarëve të zhdukur, pa rifituar pronën dhe pa marrë njohjen dhe kujdesin që u takonte.

"Shumë prej tyre ikën pa gjetur eshtrat e njerëzve të tyre, pa rifituar pronën, pa marrë njohjen dhe kujdesin që meritonin. Të tjerë vazhdojnë të mbijetojnë sot në ish-zonat e internimit ose në emigracion, të moshuar dhe të lodhur, pa e ndier seriozisht dorën mbrojtëse të shtetit", u shpreh kryetarja e Autoritetit.







Sula theksoi se ndjesa e shtetit nuk mund të mbetet vetëm në nivelin e fjalëve dhe ceremonive, por duhet të dëshmohet me njohje ligjore, mbështetje konkrete, drejtësi, kthim të të drejtave, kërkim për të zhdukurit, ruajtje të vendeve të kujtesës dhe garanci të mospërsëritjes.

"Ata nuk kërkuan dhe nuk kërkojnë privilegje. Kërkojnë të vërtetën, dinjitetin dhe drejtësinë që Republika ua ka ende borxh", theksoi Sula.

Kreu i Shtetit, Sh.T. Z. Bajram Begaj bëri thirrje për veprim dhe bashkëpunim mes institucioneve për dokumentimin e plotë të historive dhe mbrojtja e vendeve të vuajtjes së ish-të përndjekurve për edukimin e brezave të rinj.

"Koha ikën, koha nuk pret. Dëshmitarët po pakësohen, gjurmët fizike po degradojnë dhe kujtesa e drejtpërdrejtë po bëhet gjithnjë e më e brishtë.

Prandaj duhet të veprojmë: të mbledhim dëshmitë, të ruajmë fotografitë, të digjitalizojmë dokumentet, të shënojmë dhe të mbrojmë vendet e vuajtjes dhe ta bëjmë këtë histori pjesë të edukimit të brezave të rinj. Kujtesa ka nevojë jo vetëm për përvjetorë dhe ceremoni si kjo, por për institucione që e ruajnë atë çdo ditë", – u shpreh Presidenti Begaj.

Në fund të fjalës së tij, Presidenti i Republikës garantoi ish-të përndjekurit se do të jetë gjithmonë një përkrahës i kauzës së ruajtjes dhe institucionalizimit të kujtesës historike:

"Si institucion dhe si person do të mbështes nismat që ndihmojnë dokumentimin e së kaluarës, ruajtjen e kujtesës dhe edukimin e brezave të rinj, me synimin që besoj e kemi të gjithë: të ndërgjegjësojmë për padrejtësitë e së kaluarën, të ndërtojmë të ardhmen e Shqipërisë si anëtarë të denjë të familjes evropiane.

Mënyra se si ne ruajmë kujtesën sot, do të tregojë se çfarë Shqipërie duam t'u lëmë brezave që do të vijnë: një Shqipëri të drejtë, demokratike, evropiane, por mbi të gjitha, një Shqipëri humane, e cila nuk harron, nuk harron ngjarje si kjo juaja".

Kryetarja e Bashkisë Lushnjë, Eriselda Sefa, theksoi në fjalën e saj përgjegjësinë e institucioneve vendore për ruajtjen dhe shenjëzimin e vendeve të internimit, si pjesë e historisë së qytetit dhe kujtesës kombëtare.

Kryetari i Shoqatës Antikomuniste të ish- përndjekurve politikë të Lushnjës, z. Shpëtim Brehamaj, i lindur në internim dhe pinjoll i një familjeje patriotike nga Mallakastra, solli përvojën e një brezi që vuajti pasojat e dënimit kolektiv për shkak të prejardhjes familjare.

Ai kërkoi nga shteti shqiptar njohjen ligjore të viteve të internimit për fëmijët e lindur në kampet dhe vendet e internimit, duke theksuar se drejtësia ndaj tyre nuk mund të mbetet vetëm në nivelin e përkujtimit, por duhet të dëshmohet përmes vendimeve dhe veprimeve konkrete.

Në të njëjtën frymë, z. Et'hem Fejzollari, përfaqësues i Shoqatës Antikomuniste të ish-të Përndjekurve Politikë Demokratë të Shqipërisë, kërkoi përfundimin në kohë të procesit të dëmshpërblimit dhe trajtimin e drejtë të trashëgimtarëve të personave që regjimi komunist i pushkatoi pa faj. Ai ngriti shqetësimin se, për efekt dëmshpërblimi, një personi të pushkatuar i përllogariten vetëm tetë vjet burg, ndonëse regjimi i mori jetën dhe familja e tij i vuajti pasojat për breza. "Një i pushkatuar nuk mund të trajtohet sikur ka vuajtur vetëm tetë vjet burg. Atij iu mor jeta, ndërsa familjes iu mohua prindi, e drejta dhe dinjiteti. Shteti duhet ta njohë plotësisht këtë padrejtësi dhe të përmbushë pa vonesa detyrimet ndaj trashëgimtarëve", theksoi Fezollari.

Harta e deritanishme e AIDSSH-së evidenton 16 fshatra dhe vendbanime të lidhura me internimin në Lushnjë. Sipas të dhënave të Institutit të Integrimit të Ish-të Përndjekurve Politikë dhe dokumentacionit të Arkivit të AIDSSH-së, në këto zona vuajtën internimin mbi 500 familje, me rreth 2,100 persona të evidentuar.

Këto shifra nuk përfshijnë plotësisht fëmijët që lindën ose u rritën në internim. Shumë prej tyre nuk figuronin në vendimet administrative dhe nuk e përfituan më vonë statusin ligjor të të internuarit, megjithëse vuajtën të njëjtat privime dhe të njëjtën stigmë politike si familjet e tyre.

"Mungesa e emrit në një dokument nuk e zhbën dëmin e pësuar. Njohja e tyre nuk është privilegj; është drejtësi e vonuar, dinjitet dhe përgjegjësi e shtetit", - deklaroi Sula, duke përsëritur rekomandimin e AIDSSH-së për korrigjimin e këtij boshllëku ligjor.

Ndalesa në Savër, mes barakave që nesër duhet të jenë vende të vizitueshme të kujtesës

Presidenti i Republikës dhe pjesëmarrësit në tur vizituan barakat ku banonin familjet e internuara, vendin e apelit të përditshëm dhe hapësirat e ish-Ndërmarrjes Bujqësore. Ish-të internuar në këtë zonë Sofokli Kuqeshi, Vilma Mirakaj dhe Zamira Tole Hysa sollën dëshmitë e tyre për jetën nën apel, mbikëqyrjen e vazhdueshme, punën e detyruar dhe pengesat që e ashtuquajtura "biografi" u vendoste fëmijëve në arsimim dhe në jetën shoqërore.

Rrugëtimin në ndalesat e tjera të turit përkujtimor "Peizazhe të Internimit", për të dëgjuar dëshmi dhe për t'u njohur me gjurmët e sistemit të internimit në territorin e Lushnjë.





Ndalesa në Gjazë, pranë memorialit kushtuar Dom Mikel Koliqit

Pas Savrës, turi vijoi në Gjazë, ku deputeti Saimir Korreshi foli për gjurmët e internimit dhe historitë e familjeve të përndjekura në këtë zonë. Pranë memorialit të Dom Mikel Koliqit, ai nderoi viktimat e komunizmit dhe kërkoi që shtëpia ku kishte jetuar kleriku të restaurohet e të kthehet në muze, si pjesë e ruajtjes dhe muzealizimit të vendeve të kujtesës.

Dom Mikel Koliqi kaloi rreth 38 vjet të jetës së tij në burgje, kampe pune dhe internim nën regjimin komunist. Dënimin e fundit, me 15 vjet burg, e mori në vitin 1977, në moshën 75-vjeçare. Ai u lirua në vitin 1986.





Ndalesa në ish-Burgun e Grave në Kosovë të Madhe

Në ish-Burgun e Grave në Kosovë të Madhe, Elona Baçi paraqiti gjetje historike dhe arkivore mbi gratë që vuajtën dënimin në këtë kamp-burg, kushtet e jetesës, punën e detyruar, dhunën, mbikëqyrjen dhe ndarjen e tyre nga familjet.

Reparti nr. 318 funksionoi në Kosovë të Madhe nga viti 1976 deri në vitin 1990. Rreth 450 gra u transferuan fillimisht në këtë repart dhe u detyruan të punonin në Ndërmarrjen Bujqësore Kosovë. Mes tyre kishte gra të dënuara për motive politike, shtetase shqiptare dhe të huaja. Dokumentet arkivore dhe dëshmitë e të mbijetuarave e ruajnë këtë vend si një nga dëshmitë më të forta të represionit të ushtruar ndaj grave gjatë regjimit komunist.

Ndërsa rektorja e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", prof. dr. Elvira Fetahu, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit akademik me AIDSSH-në për studimin, dokumentimin dhe përcjelljen te brezat e rinj të historive të grave të burgosura gjatë regjimit komunist dhe studiuesja as. prof. Fiona Todhri trajtojnë përvojën e grave të burgosura politikisht, punën e detyruar, ndarjen nga familjet, si dhe survejimin e tyre nga ish-Sigurimi i Shtetit.

Studiuesja as. prof. Fiona Todhri, bashkautore e dokumentarit "Gratë mes dhunës dhe stigmës në komunizëm", solli historinë tronditëse të Fatime Degës, e arrestuar në vitin 1952, kur ishte vetëm 14 vjeçe, dhe e dënuar me shtatë vjet burg për "agjitacion e propagandë". Gjatë hetuesisë, ajo u mbajt për rreth katër muaj e gjysmë në një qeli të errët, pa dritare dhe pa dyshek. Në burg punoi në repartin e artizanatit, ndërsa gratë e tjera e ndihmonin të plotësonte normën, duke parë tek ajo një fëmijë të ndarë dhunshëm nga nëna dhe familja.





Rrëfimi i Fatime Degës dëshmon se represioni komunist nuk kurseu as të miturit dhe se burgosja politike e grave sho-qërohej me dhunë fizike, psikologjike, punë t

Ndër gratë që vuajtën dënimin në këtë burg ishin: Fatbardha Gjonmarkaj, Rukie Rama, Anxhe Kovaçi, Mynever Zaimi, Tefta Tasi, Asamble Hatibi, Azize Ferhati, Krisanthi Venediku, Besa Dume, Nadirja dhe Mina Shima, Lena Nikaj dhe Age Paja. Qerime Bome.

Në këtë burg u mbajtën edhe gra të huaja të martuara me shqiptarë, ndër to: Taisa Pisha, Nadia Sidorova, Zoje Gulina, Nina Puma, Barbara Haxhihyseni, Ina Shane, Elena Çami, Valja Sharanova, Igna Tarasova dhe Natalia Pengili.

Krisanthi Venediku dhe Mina Shima humbën jetën gjatë burgimit, ndërsa Age Paja vuajti 22 vjet burg. Historia e tyre dëshmon përndjekjen politike të grave, punën e detyruar dhe vuajtjen e gjatë larg fëmijëve e familjeve.

Ndalesa në Plug dhe në shkollën 9-vjeçare “Lek Pervizi”

Turi u përmbyll në Plug, në shkollën 9-vjeçare “Lek Pervizi”, e cila mban emrin e piktorit, poetit dhe ish-të internuarit që vuajti dënimin në këtë kamp ku anëtari i Autoritetit, z. Skënder Vrioni, solli kujtimet e vizitës së tij të parë në kampin e Plugut, në vitin 1985, duke rikthyer atmosferën e frikës, mbikëqyrjes dhe izolimit, por edhe solidaritetin e dinjitetin e familjeve të internuara.

Në një moment të veçantë e emocional, Kryetarja e AIDSSH-së, dr. Gentiana Sula, i dhuroi drejtoreshës së shkollës një portret të Lek Pervizit, realizuar së fundmi. E emocionuar, ajo e pranoi veprën si një dëshmi që do të mbajë të gjallë lidh-jen e shkollës me njeriun, emrin e të cilit ajo mban, dhe me historinë e vendit ku është ngritur.









Kështu, turi u mbyll aty ku kujtesa takohet me të ardhmen: në një shkollë. Portreti i Lek Pervizit nuk do të jetë vetëm një vepër e vendosur në mur, por dëshmia e një jete që dhuna nuk arriti ta nënshtrojë dhe një ftesë për nxënësit që të njohin historinë e vendit të tyre.

Sepse kujtesa bëhet e qëndrueshme vetëm kur u përcillet brezave që vijnë.

"RRMAJI – VEND KUJTESE DHE KËRKIMI"/SULA: SHTETI U KA ENDE BORXH FAMILJEVE NJË PËRGJIGJE

Shkodër më 31 Gusht, 2026

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Personave të Zhdukur, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit përuroi pranë Varrezave të Rrmajit Ekspozitën e Përhershme Informuese "Rrmaji – Vend Kujtese dhe Kërkimi".

Aktiviteti u organizua në bashkëpunim me Arqipeshkvinë Metropolitane Shkodër–Pult, Shoqatën e Ish-të Përndjekurve Politikë, Dega Shkodër, Vendin e Dëshmisë dhe Kujtesës dhe Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi". Në ceremoni morën pjesë familjarë të personave të zhdukur, ish-të përndjekur politikë, përfaqësues të institucioneve, studiues, pedagogë, qytetarë dhe përfaqësues të komunitetit fetar.

Në qendër të aktivitetit ishte mesazhi i Kryetares së AIDSSH-së, Dr. Gentiana Sula, e cila theksoi se Rrmaji nuk është vetëm një vend kujtese, por edhe një vend kërkimi, ku historia mbetet e gjallë për shkak të mungesës së mijëra njerëzve që nuk u kthyen kurrë pranë familjeve. "Shteti u ka ende borxh familjeve një përgjigje. Për familjen që kërkon, e vërteta nuk vjetrohet," theksoi Sula, duke e cilësuar 30 Gushtin, Ditën Ndërkombëtare të Viktimave të Zhdukjeve me Forcë, jo vetëm si një ditë kujtese, por si një thirrje për veprim: për të kërkuar, për të ditur, për të identifikuar dhe, kur është e mundur, për t'ua kthyer të zhdukurit familjeve të tyre.





Kryetarja e AIDSSH-së bëri të ditur se nga verifikimi i thelluar i nisur në vitin 2023 janë evidentuar 372 persona të vrarë ose të zhdukur në qarkun e Shkodrës, ndërsa për 13 prej tyre të dhënat e mbledhura e lidhin vendvarrimin e mundshëm me territorin pranë Rrmajit. "Ekspozita që hapim sot nuk e zëvendëson kërkimin. E bën atë të dukshëm. Nuk e zëvendëson drejtësinë. Na kujton se drejtësia ende ka punë për të bërë", tha Sula.

Duke iu referuar goditjes së elitës intelektuale, klerit dhe familjeve qytetare të Shkodrës, ajo nënvizoi se represioni komunist nuk i privoi vetëm familjet nga njerëzit e tyre, por i hoqi Shqipërisë dije, kulturë, ide dhe modele njerëzore që mund të kishin ndikuar në zhvillimin e vendit.

Mesazhin e saj Sula e mbylli me thirrjen "Kurrë më", duke shprehur synimin që një ditë familjet të mos vijnë më në Rrmaj për të kërkuar një të zhdukur, "por të vijnë për të vendosur një lule. Mbi një emër. Mbi një varr."

Z. Gjergj Marku, anëtar i Autoritetit dhe kryetar i grupit të punës, u ndal te puna konkrete për gjurmimin e personave të zhdukur, përmes dëshmive të familjarëve, verifikimit të dokumentacionit, identifikimit të vendvarrimeve të dyshuara dhe kërkimeve në terren me teknologji të avancuar, në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe ICMP-në. Ai shpjegoi se ekspozita është konceptuar në tri pjesë: Rrmaji si vend ekzekutimesh; përmasat e shtypjes së disidencës dhe lirisë; si dhe ngjarjet kryesore të rezistencës antikomuniste në Shkodër. "Çdo dokument, çdo dëshmi, çdo emër që rikthehet në kujtesë dhe çdo vendvarrim i identifikuar është një hap drejt së vërtetës", tha Marku, duke nënvizuar se mungesa e dokumentacionit dhe gjurmët e fshira apo të asgjësuara nga regjimi e bëjnë qartësimin e fatit të të zhdukurve një mision të vështirë, por thellësisht human ndaj familjeve që ende presin përgjigje.

Imzot Giovanni Peragine, Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër–Pultit, i cili vlerësoi rëndësinë e kujtesës, dinjitetin e viktimave dhe të drejtën e familjeve për të ditur të vërtetën.

"Sot jemi këtu jo për të ushqyer urrejtjen dhe as për të hapur plagët e së kaluarës, por për të mos lejuar që ato të mbulohen nga harresa. Kujtesa e vërtetë nuk kërkon hakmarrje; ajo kërkon të vërtetën, drejtësinë dhe pajtimin", u shpreh Imzot Peragine.

Rrmajin një vend dëshmie, dhimbjeje dhe kujtese për shumë burra e gra që vuajtën për shkak të bindjeve, fesë dhe fjalës së lirë, mes tyre meshtarë, intelektualë dhe qytetarë të Shkodrës. Kjo ekspozitë është një shërbim ndaj së vërtetës dhe brezave që vijnë.

DËSHMI

Fjalë dhe dëshmi sollën gjithashtu përfaqësues të familjeve dhe të shoqatave të ish-të përndjekurve, të cilët kërkuan vijimin e kërkimeve dhe ndërhyrjen konkrete të institucioneve përgjegjëse.





Ndoc Ashta: “Familja ime ka 12 të pushkatuar; tre prej tyre ende pa varr”

Ndoc Ashta solli historinë e xhaxhait të tij, Gjelosh Lulashit, sot martir i Kishës Katolike, i pushkatuar më 4 mars 1946 pranë Rrmajit, së bashku me Atë Gjon Shllakun, Atë Daniel Dajanin, Atë Giovanni Faustin, Mark Çunin dhe Qerim Sadikun.

“Gjyshja vendosi një shenjë hekuri në murin e varrezave dhe shkonte aty për të ndezur një qiri. Më pas, mbi atë territor u ngritën ndërtime dhe gjurmët e varreve u zhdukën”, dëshmoi Ashta. Ai u bëri thirrje historianëve, shkrimtarëve dhe gazetarëve të dokumentojnë të plotë represionin komunist dhe fatin e familjeve që ende kërkojnë eshtrat e të afërmve.

Gjergj Neli: “Prek Cali ende nuk ka një varr”

Gjergj Neli, familjar i Prek Calit, solli shqetësimin se prijësi i Kelmendit, i njohur për angazhimin në mbrojtjen e Vermoshit dhe të kufirit verior të Shqipërisë, ende nuk ka një varr ku të nderohet. Prek Cali u pushkatua më 25 mars 1945 pranë Rrmajit, por trupi nuk iu kthye familjes dhe vendvarrimi mbetet i panjohur.

Neli kujtoi se sot nuk ekziston më as kulla e Prek Calit, ndërsa familja dhe pasardhësit e tij u përndoqën, u internuan dhe u dënuan me vdekje nga regjimi komunist. Ai u bëri thirrje historianëve, shkrimtarëve dhe gazetarëve të hulumtojnë e ta paraqesin më gjerësisht këtë figurë, me të gjithë rolin dhe peshën e saj në historinë e Shqipërisë.

Lazër Thepi: “Kërkimi duhet të vazhdojë dhe historia e tyre duhet të shkruhet”

Lazër Thepi, familjar i Ndue Lazër Palit, kërkoi vijimin e kërkimeve për gjetjen e eshtrave dhe dokumentimin e plotë të historisë së viktimave. Ndue Lazër Pali u ekzekutua më 14 korrik 1945 dhe dyshohet se eshtrat e tij ndodhen pranë Varrezave të Rrmajit, ndërsa vendvarrimi i saktë mbetet i panjohur. Pas ekzekutimit të tij, familja dhe i gjithë trungu familjar u përndoqën për vite nga regjimi komunist.

“Bashkë me kërkimin e eshtrave duhet të vazhdojë edhe shkrimi i historisë së tyre”, ishte mesazhi i Lazër Thepit.





EKSPOZITA

Ekspozita përbëhet nga tri struktura informuese, të cilat paraqesin Rrmajin si vend kujtese dhe kërkimi, të drejtën e familjeve për të ditur dhe historinë e represionit komunist në Shkodër. Nëpërmjet dokumenteve, dëshmive dhe materialeve digjitale të aksesueshme me kode QR, vizitorët mund të njihen me ngjarjet, mekanizmin e shtypjes dhe përpjekjet për gjetjen e personave të zhdukur.

Në kuadër të hetimit administrativ për qarkun e Shkodrës, AIDSSH ka vendosur edhe dy tabela shenjuese në vendvarrime të dyshuara. Njëra është vendosur pas murit të Varrezave të Rrmajit, ku, sipas dëshmisë së Hamza Kazazit dhe të dhënave të administruara, dyshohet se mund të jenë varrosur eshtrat e të atit, Jup Kazazi.

Tabela tjetër është vendosur në Gruemirë, në fshatin Vorfë, në territorin ku dyshohet se mund të jetë varrosur Jaho Sali Gjonaj, ishte partizan në batalionin “Perlat Rexhepi” dhe dyshohet se u ekzekutua nga bashkëluftëtarët në muajt e fundit të luftës.





Më 9 maj 2026, AIDSSH u përcolli Prokurorisë së Përgjithshme, prokurorive përkatëse, Policisë së Shtetit, bashkive dhe institucioneve të tjera përgjegjëse dokumentacionin për pesë vendvarrime të dyshuara në vend. Autoriteti kërkoi shqyrtimin juridik të rasteve, autorizimin e gërmimeve dhe zhvarrimeve të kontrolluara, si dhe koordinimin ndërinstitucional për kërkimin, rikuperimin dhe identifikimin e mbetjeve mortore.

Kryetarja Sula u bëri thirrje institucioneve që procesi të mos mbetet në dokumente, por të vijojë me veprime konkrete në terren.

“Ne nuk mund ta kthejmë kohën pas, por mund të mos lejojmë që zhdukja fizike të pasohet nga zhdukja prej kujtesës. Kërkimi i së vërtetës do të vazhdojë, sepse emrat e tyre janë pjesë e kujtesës së Shkodrës, fati i tyre është pjesë e historisë së Shqipërisë, ndërsa gjetja e tyre është detyrim i shtetit dhe i ndërgjegjes sonë shoqërore”, përfundoi Sula.







AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Adresa: Njësia Administrative nr. 4
Rruga "Kongresi i Manastirit", Garnizoni "Skënderbej", Tiranë